

Në përputhje me nenin 58 paragrafi 5 të ligjit “Për armët” (Fletorja Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 7/2005 dhe 47/2006), Ministri i Punëve të Brendshme miratoi

RREGULLOREN PËR KËRKESAT MINIMALE TEKNIKE DHE TË SIGURISË QË DUHET TË PLOTËSOJNË OBJEKTET NË POLIGONET CIVILE TË QITJES

Neni 1

Kjo Rregullore rregullon kërkesat minimale teknike dhe të sigurisë që duhet të plotësojnë objektet në poligonet civile të qitjes të dedikuar për ushtrime rekreative ose sportive në qitje si dhe trajnimi për përdorimin e drejtë dhe të sigurt të armës së zjarrit, armët për gjueti ose sportive (në vijim referuar si: armët).

Neni 2

Ushtrimet rekreative ose sportive në qitje si dhe trajnimi për përdorimin e drejtë dhe të sigurt të armës kryhen në objektet e poligoneve të hapura ose të mbyllura civile të qitjes ose në poligonet e kombinuara civile të qitjes.

Objektet e poligoneve civile të qitjes të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni duhet të përfaqësojnë një tërësi funksionale dhe përbëhen nga:

- poligoni i hapur civil i qitjes, poligoni i mbyllur civil i qitjes ose poligonet e kombinuara civile të qitjes;
- ambientet administrative; dhe
- ambientet të siguruara teknikisht të projektuara për ruajtjen e armëve (në vijim referuar si: depot).

Neni 3

Në objektet e përmendura në nenin 2 paragrafi 2 pika 1 të kësaj Rregulloreje, duhet të ketë hapësira të mjaftueshme për qitje me të paktën tre korsi qitjeje.

Në objektet e përmendura në nenin 2 paragrafi 2 pika 1 të kësaj Rregulloreje, përveç ambientit të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, duhet të ketë edhe një ambient të veçantë të shënuar për të mësuar përdorimin e armës në mënyrë që personi fizik i cili kryen ushtrime rekreative ose sportive në qitje mund edhe të trajnohet për përdorimin e duhur dhe të sigurt të armës (në vijim referuar si: personi fizik), të kryejë qitje me armën, pra ta montojë, çmontojë dhe pastrojë atë.

Neni 4

Poligoni i hapur i qitjes duhet të ndërtohet larg qendrave të banuara me dimensione jo më të vogla se:

- gjashtë metra gjerësi dhe pesëmbëdhjetë metra gjatësi, për ushtrimet me armë dhe trajnimet për përdorimin e armëve të zjarrit të shkurtra;
- tetë metra gjerësi dhe dyzetë e pesë metra gjatësi, për ushtrimet me armë dhe trajnimet për përdorimin e armëve të zjarrit të gjata me tytë të pavjaskuar dhe
- tetë metra gjerësi dhe njëqind e dhjetë metra gjatësi, për ushtrimet me armë dhe trajnimet për përdorimin e armëve të zjarrit të gjata me tytë të vjaskuar.

Neni 5

Terreni ku ndodhet poligoni i hapur i qitjes duhet të ketë mbrojtje anësore natyrore ose artificiale.

Në kuptimin e kësaj Rregulloreje, terreni i përmendur në paragrafin 1 të këtij neni ka mbrojtje anësore natyrore, nëse ndodhet në grykë, kanion, afër një dige, muri, etj.

Në kuptimin e kësaj Rregulloreje, terreni i përmendur në paragrafin 1 të këtij neni ka

mbrojtje anësore artificiale, nëse është i mbrojtur me argjinaturë dheu ose mur me lartësi të paktën dy metra e 50 centimetra.

Argjinatura e dheut e përmendur në paragrafin 3 të këtij neni, duhet të ketë një pjerrësi 45 gradë krahasuar me tokën ku ndodhet poligoni i hapur.

Muri i përmendur në paragrafin 3 të këtij neni, duhet të jetë i ndërtuar me betonarme, të cilësisë MB15, të paktën 12 cm i trashë ose i ndërtuar me tulla solide me trashësi të paktën 24 cm.

Neni 6

Poligoni i hapur i qitjes, përveç mbrojtjes së përcaktuar në nenin 5 të kësaj Rregulloreje, duhet të ketë edhe një mbrojtje artificiale të sipërme, vetëm nëse është i ndërtuar afër qendrave të banuara.

Mbrojta e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, përbëhet nga panele të vendosura në mënyrë transversale përgjatë gjithë gjatësisë së poligonit.

Panelet e përmendura në paragrafin 2 të këtij neni, janë të punuara me betonarme, të cilësisë MB 30, me trashësi deri në 20 centimetra.

Pjesët e paneleve, që janë përballë pjesës së poshtme të poligonit të hapur, duhet të jenë të mbrojtura me panele druri të butë dhe të plotë, me trashësi 24 milimetra, të vendosura pesë centimetra larg nga panelet.

Neni 7

Poligoni i hapur i përmendur në nenin 6 të kësaj Rregulloreje, përgjatë gjithë gjatësisë së tij duhet të jetë i rrethuar me gardh prej teli të thurur ose material tjetër të ngjashëm.

Gardhi i përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, duhet të vendoset jashtë argjinaturës së dheut ose murit të përmendur në nenin 5 paragrafi 3 të kësaj Rregulloreje, me lartësi të paktën mbi dy metra.

Përgjatë të gjithë gjatësisë së gardhit të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni dhe në pikat e hyrjes në poligonin e hapur duhet të ketë tabela me shenja të dukshme paralajmëruese, në ngjyrë të verdhë, të gjera 70 centimetra dhe të gjata 100 centimetra, mbi të cilat në ngjyrë të zezë do të shkruhet: “POLIGON QITJEJE-NDALOHET HYRJA”.

Neni 8

Vijat e zjarrit në poligonet e hapura, përveç mbrojtjes së përmendur në nenin 6 të kësaj Rregulloreje, duhet të jenë të mbrojtura edhe nga ndikimet atmosferike.

Ndërmjet vijave të zjarrit të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni në poligonin e hapur duhet të ketë distancë prej të paktën një metër e 50 centimetra.

Neni 9

Sipërfaqja e poshtme e vijës së zjarrit në poligonin e hapur, veçanërisht hapësira nga vija e zjarrit deri tek shënjestrat, duhet të jetë e mbuluar me dhe ose rërë të shkrifët, e shpërndarë në mënyrë uniforme e cila nuk duhet të përmbajë guriçka apo mjete të tjera të forta.

Neni 10

Sipërfaqja që pranon gjuajtjen e predhës në poligonet e hapura duhet të mundësojë ndalimin e plotë të predhës, pa mundësi për rikoshetimin e saj në çdo drejtim.

Sipërfaqja e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni mund të jetë natyrale (pjerrësi kodre, grykë apo luginë) ose të jetë e ndërtuar në formë strukture mbrojtëse nga materiale që mundësojnë ndalimin e plotë të predhës, pa mundësi për rikoshetimin e saj në të gjitha drejtimet.

Neni 11

Në terrenin rreth poligonit të hapur, në pikat më të larta të dukshme, gjatë kohës së ekzekutimit të qitjes në poligon, duhet të vendosen flamuj të kuq që paralajmërojnë rrezik.

Neni 12

Poligoni i mbyllur duhet të jetë i vendosur në objekte me përmasa mbi katër metra gjerësi dhe pesëmbëdhjetë metra gjatësi, të ndërtuara posaçërisht për ushtrime rekreative dhe sportive në qitje si dhe për trajnime për përdorimin e duhur dhe të sigurt të armës ose në objekte të projektuara për realizimin e ushtrimeve rekreative-sportive në qitje dhe për trajnime për përdorimin e duhur dhe të sigurt të armës, që plotësojnë kërkesat dhe kushtet e parashikuara në dispozitat e kësaj Rregulloreje.

Në objektin e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, në hapësirën ku kryhet qitja, muri pas objektivit dhe muret anësore nuk duhet të kenë dritare.

Gjatë përdorimit, objekti i përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, duhet të jetë mekanikisht i rezistueshëm, i qëndrueshëm dhe të ketë mbrojtje sizmike.

Struktura mbështetëse e objektit të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, duhet të jetë e ndërtuar me material që është rezistent ndaj zjarrit për të paktën dy orë.

Lartësia e objektit të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, nga dyshemeja deri në tavan duhet të jetë të paktën dy metra e njëzetë centimetra.

Neni 13

Në objektin e poligonit të mbyllur, muri, tavani dhe të gjitha projeksionet që janë të vendosura në drejtim të lëvizjes së predhës së armës, duhet të jenë të mbështjella me dru të butë me trashësi 24 milimetra ose material tjetër të ngjashëm, me veshje mbrojtëse rezistente ndaj zjarrit.

Neni 14

Dyshemeja e poligonit të mbyllur të qitjes, duhet të jetë e mbështjellë me material që nuk merr flakë dhe që zbut gjuajtjen e plumbit, dhe pas përdorimit është e lehtë për t’u mirëmbajtur.

Neni 15

Ndërmjet vijës nga e cila kryhet qitja (në vijim referuar si: vija e zjarrit) dhe sipërfaqes që pranon gjuajtjen e predhës në poligonet e mbyllura, duhet të ketë distancë minimalisht 10 metra nga njëra-tjetra.

Mes vijës së zjarrit dhe murit mbas vijës së zjarrit në poligonet e mbyllura duhet të ketë të paktën dy metra distancë.

Neni 16

Ndërmjet korsive të qitjes në poligonin e mbyllur duhet të ketë distancë të paktën një metër.

Neni 17

Korsitë e qitjes në poligonet e mbyllura, duhet të jenë të ndara njëra nga tjetra me paret, me gjerësi 150 centimetra dhe gjatësi 170 centimetra.

Skaji i poshtëm i paretit duhet të jetë i vendosur jo më pak se 70 centimetra nga dyshemeja e objektit të poligonit të mbyllur, ndërsa skaji i sipërm i paretit duhet të jetë mbi 200 centimetra nga dyshemeja e objektit.

Pareti i përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, duhet të jetë i vendosur të paktën 50 centimetra përpara vijës së zjarrit, në drejtimin e lëvizjes së predhës.

Neni 18

Para çdo korsie për qitje në poligonet e mbyllura, duhet të ketë një tavolinë për vendosjen e armës dhe të municioneve, me gjerësi të paktën 40 centimetra dhe gjatësi të njëjtë me gjerësinë e korsisë së qitjes.

Tavolina e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, vendoset në lartësi deri në një metër nga dyshemeja e objektit të poligonit të mbyllur.

Neni 19

Pjesa e pasme e objektivave mbi të cilat realizohet qitja në poligonet e mbyllura, duhet të jetë e punuar me material joreflektues.

Neni 20

Përpara sipërfaqes që pranon predhën në poligonet e mbyllura, duhet të ketë perde me shirita gome, të cilat parandalojnë devijimin e mbetjes së plumbave në drejtim të personit fizik që kryen qitjen ose provën.

Neni 21

Objekti ku është vendosur poligoni i mbyllur duhet të jetë i ndriçuar me të paktën 300 lux. Objektivit ku realizohet qitja në poligonet e mbyllura duhet të jetë i ndriçuar njëtrajtësisht me të paktën 1000 lux.

Neni 22

Gazet e barutit dhe pluhuri i plumbit që krijohet gjatë gjuajtjes me armë në poligonet e mbyllura duhet të largohen përmes instalimit të pajisjeve të ventilimit.

Gjatë kohëzgjatjes së qitjes me armë, gazet e barutit dhe pluhuri i plumbit duhet të largohen me të paktën 12 shkëmbime të ajrit në orë, me pajisjet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, të vendosura në distancë të paktën tre metra nga korsia e qitjes dhe sipërfaqja që pret predhën.

Ajri i pastër futet në poligonet e mbyllura nëpërmjet pajisjeve të ventilimit të vendosura në tavan ose në mur, pas korsisë së qitjes dhe sipërfaqes që pret predhën.

Neni 23

Instalimet elektrike dhe ato të ventilimit si dhe pajisjet e ndriçimit, duhet të jenë të instaluara në mënyrë që të mundësojnë mbrojtje të sigurt të instalimeve dhe pajisjeve nga goditjet e plumbave.

Paneli qendror i instalimeve dhe pajisjeve të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni duhet të jetë i vendosur jashtë ambientit ku kryhet qitja në poligonin e mbyllur.

Neni 24

Tingulli që krijohet nga qitja në poligonet e mbyllura duhet të izolohet me material që nuk ndizet lehtësisht ose në rast zjarri fiket vetë.

Nivelet e tingullit të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni nuk duhet të kalojnë më shumë se 85 decibelë.

Jashtë objektit të poligonit të mbyllur, nivelet e tingullit nuk duhet të kalojnë më shumë se 70 decibelë, ndërsa në objektin më të afërt të banimit fortësia nuk duhet të kalojë me shumë se 45 decibelë.

Neni 25

Dispozitat e neneve 4 deri në 24 të kësaj Rregulloreje zbatohen përkatësisht edhe në poligonet e mbyllura edhe në ato të hapura.

Neni 26

Në ambientet administrative të poligoneve të përmendura në nenin 2 paragrafi 2 pika 2 të kësaj Rregulloreje, kryhen punë që lidhen me çështjet administrative dhe me pritjen dhe dhënien e njoftimeve të nevojshme për personat fizikë.

Neni 27

Depot e përmendura në nenin 2 paragrafi 2 pika 3 të kësaj Rregulloreje, duhet të jenë teknikisht të siguruara nga hyrja e paautorizuar e personave të tjerë dhe duhet të jenë të ndara fizikisht nga objektet e përmendura në nenin 2 paragrafi 2 pika 1 të kësaj Rregulloreje.

Neni 28

Në kuptimin e kësaj Rregulloreje, siguria teknike e depos ndaj hyrjeve të paautorizuara të personave të tjerë nënkupton mbrojtjen mekanike dhe elektrike të depos.

Neni 29

Dritaret e depos duhet të jenë të mbrojtura nga ana e jashtme me rrjetë metalike të lëvizshme ose me zbara metalike të fiksuara.

Rrjeta metalike e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, duhet të jetë me trashësi deri në pesë milimetra, ndërsa vrimat përbërëse duhet të jenë me dimensione të paktën 70 milimetra gjatësi dhe 70 milimetra gjerësi.

Zbarat e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, duhet të jenë me trashësi të paktën dhjetë milimetra, të vendosura vertikalisht me distancë të paktën 100 milimetra dhe horizontalisht me distancë të paktën 300 milimetra.

Neni 30

Porta e jashtme e depos duhet të jetë e mbrojtur nga ana e jashtme, me rrjetë metalike të lëvizshme ose me zbara metalike të lëvizshme, e cila nga njëra anë fiksohet në murin e jashtëm, ndërsa në anën tjetër kyçet me shul.

Dispozitat e nenit 29 paragrafi 2 dhe 3 të kësaj Rregulloreje, zbatohen përkatësisht edhe për mbrojtjen e portës së jashtme të depos.

Gjatë kohës së rregullt të punës në poligonet civilë, vetëm porta e jashtme e depos duhet të jetë e mbyllur, ndërsa çelësin duhet ta mbajë personi i autorizuar për armët dhe municionet.

Neni 31

Muret e jashtme dhe tavani i depos duhet të ndërtohen me tullë, beton, gurë dhe materiale të tjera që përdoren për ndërtimin e objekteve.

Materialet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, që janë përdorur për ndërtimin e depos, duhet të jenë rezistente ndaj zjarrit si me poshtë:

- muret, të paktën për dy orë;
- dyshemeja dhe tavani, për të paktën një orë e 30 minuta; dhe
- dyert dhe dritaret, për të paktën një orë.

Neni 32

Në kuptimin e kësaj Rregulloreje, mbrojtje elektrike e depos konsiderohet sistemi i panelit të sigurisë me alarme elektronike që zbulojnë hyrjen e paautorizuar në depo.

Neni 33

Në objektet e përmendura në nenin 2 paragrafi 1 të kësaj Rregulloreje, që nuk kanë depo, duhet të kenë kasaforta të veçanta rezistente ndaj zjarrit për ruajtjen e armëve dhe të municioneve.

Në kuptimin e kësaj Rregulloreje, kasaforta rezistente ndaj zjarrit konsiderohen kasafortat e sigurisë ose dollapët, e punuar me fletë çeliku me dy shtresa ndërmjet të cilave duhet të ketë veshje izoluese kundër zjarrit.

Kasaforta ose dollapi i përmendur në paragrafin 2 të këtij neni, ku ruhen vetëm municione, duhet të jenë të mbrojtura me sistem tokëzimi.

Neni 34

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në “Fletoren Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.

Numër 13.1-5266/1

25 janar 2007

Shkup

Ministre

e Punëve të Brendshme,

MA Gordana Jankuloska, nënshkrimi